



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 203, Datë 04.10.2021**

**MBI**

**PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË GARANCISË SË ORIGJINËS PËR PERIU DHËN  
KALENDARIKE 2020 PËR IMPIANTIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE  
“HEC BANJË”, TË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; nenit 16, pika 6, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 7, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019; dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 04.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Mbikqyrjes dhe Autorizimeve, me nr.124/1 prot., datë 30.09.2021, lidhur me “Pajisjen me Certifikatë të Garancisë së Origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.,

**Konstatoi se:**

- Në vijim të komunikimeve shkresore dhe së fundi me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 882/2 prot., datë 22.09.2021, shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., ka kërkuar:
  - Paisjen me Certifikatën e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC Banjë për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020.
  - Zgjatjen e vlefshmërisë së Garancisë së Origjinës për HEC Banjë për periudhën kalendarike 2021.
- Impianti prodhues HEC Banjë nuk ka pësuar ndryshime referuar kërkesave të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.

- Kërkesa e shoqërisë Devoll Hydropower sh.a., i nënshtrohet vendimmarrjes së ERE-s për sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga HEC Banjë për vitin 2020 (sasia prej 135,775 MWh).
- Sa i përket kërkesës së shoqërisë Devoll Hydropower sh.a., për zgjatjen e vlefshmërisë së Garancisë së Origjinës për HEC Banjë për periudhën kalendarike 2021, duke qenë se kjo e fundit nuk ka dokumentuar shifra konkrete, në zbatim të nenit 16, pika 6, e ligjit nr. 7/2017, *“Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”* dhe nenit 11, pika 3, të *“Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”*, ERE shprehet vetëm për energjinë elektrike realisht të prodhuar nga impianti. Si e tillë, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE sasinë faktike të energjisë elektrike për vitin 2021.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të pajisë me Certifikatë të Garancisë së Origjinës impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. për një periudhë 12 – mujore (01.01.2020 – 31.12.2020), për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike 135,775 MWh.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë shoqërinë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**